

1. Gjatë periudhës së fushatës, sidomos në ditët e fundit të saj, rezulton se Presidentit i Republikës ashpërsoi retorikën kundrejt institucioneve shtetërore. Për të Bashkia e Tiranës ishte “bashkia bandë”:

12.03.2021 Meta live në zyrat e FRD “ I bëj thirrje gjithë opozitës që të zgjohet dhe të mos lejojë më asnjë prekje të rregullave të garës sepse do jetë vonë për të në rast se toleron sjelljet e partisë bandë. Po e paralajmëroj policinë, zbatoni ligjet! Po i them kryepalaços së bashkisë bandë e di se çfarë ke bërë me firma. Mos iu bind urdhrave të të çmendurit sepse ai do nxjerrë kartelën e të sëmurit psikik. E konsideroj si një përpjekje për grusht shteti. T’i sjellësh një partie zyrtare, opozitare menjëherë pasi nënshkruan një marrëveshje me PD dhe partitë e Opozitës, për të marrë pjesë në zgjedhje, t’i sjellësh një shkresë të tillë që nuk ka as vulë, as emër titullari për të mbajtur përgjegjësi nesër, të bërë me vrap e nxitim vetëm për të dhunuar fizikisht, por edhe psikologjikisht çdo forcë opozitare duke keqpërdorur bashkinë-bandë, padyshim që është tepër irrituese”. (<https://dosja.al/lajm-i-fundit-i-them-kryepalacos-se-bashkise-bande-meta-paralajmeron-veliajn-mos-iu-bind-me-te-cmendurit/>).

2. Në analizë të shkresave të marra në shqyrtim dhe pamjeve filmike për konfliktin midis Bashkisë dhe Frymës së Re Demokratike për selinë e kësaj të fundit, konstatohet ndërhyrje e Presidentit në çështje që përbëjnë thelbin e veprimtarisë së tyre organeve të rendit dhe pushtetit vendor. Konkretisht, në pamjet filmike datë 12.03.2021 vënë në dispozicion nga Autoriteti i Medieve Audiovizive me CD përkatëse, Presidenti shfaqet me gjuhë e veprime aspak të denja për kreun e shtetit dhe përfaqësuesin e unitetit të Kombit, por dhe me sjellje që kërcënojnë strukturat e policisë vendore. Këto shprehje përbëjnë kërcënim e kritika ndaj organeve të pushtetit vendor dhe organeve vendore të rendit, përtej kompetencave kushtetuese që i lejojnë Presidentit, pasi janë ndërhyrje në veprimtarinë e pushtetit vendor që vepron sipas parimit të autonomisë vendore. Çdo vendimmarrje e autoritetit vendor që çmohet e gabuar apo e paligjshme mund të kundërshtohet nga subjektet që legjitimohen në rrugë administrative e më tej t’i shtrohet për zgjidhje e kontroll pushtetit gjyqësor, dhe asnjë organ tjetër, qoftë ky dhe Presidenti i Republikës nuk mund të ndërhyjë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të tilla.

3. Sado e gabuar të pretendohej nga Presidenti procedura që po ndiqte Bashkia Tiranë, Presidenti duhej të gjente mjetet e duhura brenda caqeve që i lejon Kushtetuta dhe ligji nëse vlerësonte se mund të kontribuonte në zgjidhjen e një mosmarrëveshjeve, dhe jo të ushtronte autoritetin e tij me situata që i ngjajnë vetëgjyqësisë, pasi në këtë formë ai ka ndërhyrë në mënyrë të kundërligjshme në pavarësinë e pushtetit vendor. Pamjet filmike janë të rënda dhe denigrojnë figurën e Presidentit të Republikës, por në të njëjtën kohë prishin edhe imazhin e vendit të cilin Presidenti duhet të përfaqësojë në formën më të mirë të mundshme.

4. Shfaqja e Presidentit në pamjet filmike të mësipërme është jashtë caqeve që atij i lejon Kushtetuta, pasi të gjitha veprimtaritë e Presidentit të Republikës duhet të bazohen në respektin ndaj shtetit, të gjitha institucioneve të tij. Statusi kushtetues i Presidentit të Republikës nënkupton detyrën e tij për të shmangur konfliktin e degëve të pushtetit, nga kritikrat e tij publike ndaj institucioneve të tjera shtetërore ose zyrtarëve të tyre, si dhe nënvlerësimin të paarsyeshëm,

mohimit të paarsyetuar të vendimeve të tyre. Statusi i jashtëzakonshëm kushtetues i Presidentit të Republikës dhe roli i tij në shtet e detyron atë të zgjedhë forma të duhura, korrekte të shprehjes së kritikës. Në rast se këto kërkesa nuk merreshin parasysh, besimi i Kombit në vetë institucionin e Presidentit të Republikës do të degradohej dhe autoriteti i këtij institucioni do të zvogëlohej¹.

5. Presidenti jo vetëm që ndërhyri në pavarësinë dhe veprimtarinë e pushtetit vendor, siç rezultoi nga pamjet filmike datë 12.03.2021 analizuar më sipër, por vijoi të insistonte në këtë ndërhyrje dhe më pas. Rezulton nga aktet e marra në shqyrtim, konkretisht shkresa nr. 1027, datë 17.03.2021 “Mbi tentativën e maxhorancës dhe Bashkisë Tiranë për cenimin e veprimtarisë së një partie opozitare, pjesëmarrëse në zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021” e Presidentit të Republikës drejtuar Kryetarit të Kuvendit dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe përfaqësuesve diplomatikë në vend, se Presidenti i bën me dije atyre gjithë situatën e ndodhur duke listuar dhe shkeljet që ai pretendon se ka kryer Bashkia Tiranë. Në këtë shkresë, Presidenti shpreh se lirimi i ambienteve të FRD është kërkuar nga Bashkia vetëm se ky subjekt iu bashkua aleancës së kryesuar nga Partia Demokratike për zgjedhjet e vitit 2021 dhe ndër të tjera shprehet se...

“Ky sulm, që u organizua dhe ekzekutua vetëm pak ditë më parë, në datën 12 mars 2021, pas nënshkrimit të një marrëveshjeje të FRD-së me PD-në dhe aleatët e saj për zgjedhjet e 25 prillit 2021, bie ndesh me të gjitha parimet demokratike të shtetit të së drejtës.....”.....Ky sulm është një tjetër tregues i sjelljes tërësisht të papërgjegjshme dhe provokuese të maxhorancës.....”

6. Insistimi i Presidentit me këtë shkresë për të ndërhyrë në konfliktin midis FRD dhe Bashkisë Tiranë, dhe për të përcjellë kritikën e veta ndaj kësaj të fundit, konsiderohet nga Komisioni Hetimor si ndërhyrje e papërshtatshme dhe jashtë caqeve që i lejon Kushtetuta si kreu i shtetit. Kjo për arsye se, siç u arsyetua më sipër, kjo është një çështje që i përket veprimtarisë së organeve të pushtetit vendor dhe objekt kontrolli gjyqësor, dhe gjykimet e Presidentit nuk mund të mbivendosen me këto veprimtari. Nga ana tjetër, Presidenti nuk ka asnjë kompetencë të përcaktuar në Kushtetutë për të qenë autoritet për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Në fakt, konflikti iu shtrua për zgjidhje gjykatës², ndërkohë që një kallëzim penal u depozitua në organin e prokurorisë nga autoritetet e Bashkisë Tiranë (shkresa 18884/3, datë 14.05.2021 e Bashkisë Tiranë), pra palët ndoqën mjetet ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Çdo veprim që kreu Presidenti në lidhje me konfliktin midis FRD dhe Bashkisë, nuk kontribuoi për uljen e tensioneve që u krijuan apo për zgjidhjen e çështjes, përveç politizimit të rastit, situatë kjo që e vuri Presidentin dhe në shkelje të pozitës neutrale/asnjanëse që ai duhet të mbajë si kreu i shtetit.

¹Vendimi i Gjykata Kushtetuese së Lituanisë nr. 14/04, datë 31 mars 2004.

² Shkresa e Bashkisë Tiranë 18884/3, datë 14.05.2021 lidhur me procedurat e kryera prej saj gjatë ekzekutimit të lirimit të ambjenteve të zyrave të, aktet përkatëse, si dhe informacioni mbi ndërhyrjen dhe veprimet e kryera nga Presidenti i Republikës lidhur me këtë çështje, protokolluar në Kuvend me nr. 1081/24, datë 14.05.2021.